

**2013**

# PARASHIKIMI BIZNESOR

**Botimi numër 07/2013**





KOLEGJI  
UNIVERSUM

## Kolegji Universum

### DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE SHKENCORE

**Autor:**

Festina Balidemaj  
Kolegji Universum

**Botues:**

Departamenti i Kërkimeve Shkencore  
Instituti për Studime Ekonomike dhe Sociale  
Kolegji Universum

**Këshilli Editorial:**

Alejtin Berisha  
Alban Asllani  
Uran Rraci  
Nita Luzha  
Ejup Fejza  
Mergim Cahani

*E drejta e kopjimit të raportit të Barometrit të Punësimit nuk mbrohet nga ana e botuesit dhe as nga ana e mbledhësve të të dhënave. E drejta e autorit të raportit të Barometrit të Punësimit mbrohet në kufijtë e referimit tek autorët gjegjës. Të drejtat morale mbi këtë botim mbrohen nga botuesi dhe autorët.*

---

## **Botimi numër 07/2013**

*E drejta e autorit mbi të dhënat e mbledhura i takon studentëve të cekur më poshtë:*

---

*Studentët e vitit të parë të drejtimeve Biznes dhe Menaxhment dhe Administratë Publike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kampuset e kolegjit Universum të Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit dhe Ferizajit.*

*Parashikimi biznesor është një publikim i kolegjit Universum për Studime Ekonomike dhe Sociale, i cili ka për qëllim matjen e trendeve, dinamikës dhe strukturës së lëvizjeve në bizneset e tregut të Kosovës. Parashikimi biznesor publikohet një herë në vit, dhe përmban të dhëna statistikore krejtësisht të mbledhura dhe analizuara nga stafi dhe studentët e kolegjit Universum. Si rezultat, produkti kërkimor i Parashikimit biznesor ka origjinë parësore punën kërkimore të kolegjit Universum. Parashikimi biznesor editohet nga një Krye-Editorë dhe të dhënat e mbledhura përfshirë përpunimin e tyre, i nënshtrohen një procedure anonime të recensimit.*

*Parashikimi biznesor publikohet në versionin online dhe në versionin e shtypur, një herë në vit.*

---

## *Përmbledhje e hulumtimit*

### *(Hyrja dhe Metodologjia)*

---


Ky numër i Parashikimit biznesor bazohet në një masë statistikore të përbërë nga anketimi i përafërsisht 359 firmave në Kosovë, me anë të 610 anketave, duke përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës. Anketimi prej studentëve përfshinë: Prishtinën, Fushë Kosovën, Kamenicën, Obiliqin, Lipjanin, Ferizajin, Gjilanin, Kacanikun, Dragashin, Prizrenin, Suharekën, Rahovecin, Gjakovën, Malishevën, Decanin, Pejën, Klinën, Glogocin, Istogun, Vushtrinë, Skënderaj, Mitrovicën dhe Podujevën. Anketimi i pyetjeve është bartur nga studentët e kolegjit Universum (nga katër kampuset e kolegjit, duke përfshirë dy kampuset e Prishtinës, kampusin e Prizrenit, të Gjakovës dhe të Ferizajit), të cilëve u takon e drejta e autorit mbi të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport. Analiza e të dhënave është implementuar me ndihmën e Google Drive dhe Microsoft Excel.

Parashikimi biznesor, botimi 07/2013 ka bërë një matje të perceptcionit të bizneseve në lidhje me ndikimin e disa faktorëve në dinamikën dhe trendin e klimës së biznesit. Siç evidenton ky botim, bizneset në Kosovë shprehin një frikë të arsyeshme ndaj klimës së biznesit, dhe ndaj rritjes së profitit të tyre, fenomen ky më shumë i shprehur nga bizneset e vogla. Parashikimi biznesor gjithashtu ka vërejtur që bizneset e vogla kanë këndvështrim më negativ sa i përket faktorëve që ndikojnë në suksesin e tyre. Me këtë hulumtim kemi gjetur se klima e biznesit, këtë vit ofron një perceptcion më pozitiv për bizneset e mëdha. Momentalisht konkludojmë që ekziston një korrelacion negativ në mes të pozitivitetit të perceptcionit të bizneseve dhe madhësisë së tyre.

## Rezultatet

### KËNDVËSHTRIMI I BIZNESEVE PËR PËRMIRËSIMIN OSE KEQËSIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME BIZNESORE NË 12 MUAJT E ARDHSHËM

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 1:




**Fig. 1.** Këndvështrimi i bizneseve për përmirësimin ose keqësimin e kushteve të përgjithshme biznesore në 12 muajt e ardhshëm.

Parashikimi biznesor, në bazë të kësaj pyetje konkludon që shumica e bizneseve perceptojnë se e ardhmja 12 mujore është pozitive sa i përket kushteve të përgjithshme të bizneseve. Nga tre kategoritë e bizneseve, siç tregon evidenca, bizneset e mëdha dhe ato të mesme kanë përqindjen më të lartë të perceptcionit pozitiv përballë

12-mujorit të ardhshëm, ndërsa bizneset e vogla shprehen me një perceptcion më negativ sa i përket kushteve biznesore në fjalë. Klima biznesore në Kosovë ka një tendencë që të ofroj kushte më të mira për bizneset e mëdha dhe të mesme (me të dhëna signifikante të ngjajshme), sesa për ato të vogla.

## RRJEDHJA E AKTIVITETIT BIZNESOR NË 12 MUAJT E ARDHSHËM

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 2:




**Fig. 2.** Rrjedhja e aktiviteteve biznesore në 12 muajt e ardhshëm

Në përgjithësi, hulumtimi tregon që bizneset tregojnë një ambient pozitiv biznesor, sa i përket aktivitetit të tyre prodhuese dhe shërbyese. Siç konstaton evidenca e mësipërme, bizneset e mëdha e perceptojnë në mënyrë më pozitive aktivitetin biznesor në 12-muajt e ardhshëm. Shtatëdhjetë e tetë për qind të bizneseve të mëdha e shohin 12- mujorin e ardhshëm si rritës të aktivitetit të tyre biznesor. Krejt e kundërta ndodhë me bizneset e vogla. Vetëm 49% e bizneseve të vogla perceptojnë rritje të performancës së tyre biznesore në 12-muajt e ardhshëm, derisa 39 % e tyre nuk pretendojnë që do arrijnë ngritje në aktivitetin e tyre prodhues/shërbyes. Për më tepër, 12% e bizneseve të vogla e shohin 12-mujorin e ardhshëm si *zvogëlues* të aktivitetit të tyre biznesor. Edhe në këtë rast, siç tregon evidenca e mësipërme, sugjerohet që perceptioni më pozitiv për zhvillim të aktivitetit biznesor ekziston tek bizneset e mëdha, të cilat i pasojnë bizneset e mesme, përderisa bizneset e vogla japin perceptonin më negativ sa i përket aktivitetit të tyre biznesor. Kjo sërish sjell tek sugjerimi që, klima biznesore në Kosovë, siç tregon perceptioni i bizneseve, ka një tendencë të ofrimit të një ambienti më pozitiv për bizneset e mëdha dhe të mesme, siç nuk ndodh me perceptonin e bizneseve të vogla, njësoj sikur është vërtetuar në hulumtimin e vitit 2010.

## KËNDVËSHTRIMI I PUNËDHËNËSVE MBI RITJEN E PROFITIT TË BIZNESEVE NË 12 MUAJT E ARDHSHËM

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 3:




**Fig. 3.** Këndvështrimi i punëdhënësve mbi rritjen e profitit të bizneseve në 12 muajt e ardhshëm

Në përgjithësi, parashikimi biznesor tregon që ekziston një perceptcion përgjithësisht pozitiv sa i përket rritjes së profitit prej bizneseve të Kosovës. Rritja e profiteve është më e madhe tek bizneset e mëdha dhe të mesme. Pra, parashikimi biznesor sugjeron që 12 muajt e ardhshëm kanë perceptcion më negativ tek bizneset e vogla.

## PERCEPCIONI MBI NORMËN E INTERESIT KREDITOR

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 4:




**Fig. 4.** Percepcioni mbi normën e interesit kreditor

Evidenca e mësipërme tregon se përgjithësisht ekziston këndvështrimi se normat e interesit do të mbesin të njëjta, sikur që kemi gjetur edhe në hulumtimin e vitit 2010. Parashikimi biznesor sugjeron që institucionet gjegjëse duhet të marrin masa themelore për të ulur riskun e kreditimit, dhe si pasojë për të stimuluar uljen e normës së interesit, meqë investimet e kredituara janë forma themelore e investimit në ambientin biznesor të Kosovës.

Edhe në këtë pjesë të hulumtimit vëzhgojmë se bizneset e vogla parashikojnë të kenë rritjen më të madhe në interesin kreditor.

## KËRKESA NË TREG PËR MALLËRAT DHE SHËRBIMET E BIZNESEVE

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 5:




**Fig. 5.** Kërkesa në treg për mallërat dhe shërbimet e bizneseve.

Nga të dhënat e këtij hulumtimi mund të thuhet që, të tre llojet e bizneseve shohin një rritje të kërkesës për mallra dhe shërbime në treg. Në këtë kontekst, 68% e bizneseve të vogla perceptojnë që kërkesa për mallra dhe shërbime në 12-muajt e ardhshëm do të rritet. Kjo bie në kundërshtim me perceptcionin negativ që kanë bizneset e vogla, siç shihet nga fig. 3 në lidhje me rritjen e profitit të tyre. Në anën tjetër, perceptcioni se kërkesa në treg do të pësojë një rritje të konsiderueshme, sugjeron që, eventualisht, mallrat dhe shërbimet në Kosovë do të pësojnë inflacion (inflacion të kërkesës), si rezultat i shtimit të kërkesës. Prandaj, institucionet gjegjëse duhet të kujdesen që tregu në Kosovë të ruhet nga një inflacion i skajshëm i kërkesës që mund të sjellet, siç tregon edhe evidenca, nga rritja eventuale e kërkesës.

## ÇMIMET E SHËRBIMEVE DHE MALLËRAVE QË OFROJNË BIZNESET

Përgjigjet e respondentëve në pyetjen e mëposhtme janë paraqitur në figurën 6:




**Fig. 6.** Çmimet e shërbimeve dhe mallërave që ofrojnë bizneset.

Evidenca e mësipërme tregon që, bizneset perceptojnë që çmimet e mallrave dhe shërbimeve do mbesin të njëjta. Kjo është një indikator që, nuk do ketë as rritje por as zvogëlim inflacioni, e ngjajshme me të dhënat e mbledhura në vitin 2010.

Në lidhje me evidencën e paraqitur më lartë, gjithashtu vërehet se, parashikimi se çmimet do të vazhdojnë të mbesin të njëjta është shenjë negative për ritmin ekonomik dhe klimën e biznesit, meqë një rritje e lehtë e inflacionit shkaktohet prej rritjes së performancës biznesore. Prandaj, ky parashikim konstaton që, percepticioni aktual i bizneseve për mos-rritje të çmimeve, është indikator i ritmit të njëjtë që do të përcjellë klima biznesore. Kjo nuk shpreh një perspective të rritjes së performances biznesore.

## INVESTIMET E BIZNESEVE

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 7:




**Fig. 7.** Investimet e bizneseve

Nga të dhënat e mësipërme shihet se investimet nga biznesi do rriten gjatë 12-mujve të ardhshëm. Ky perceptcion është më pozitiv tek bizneset e mëdha, dhe më pak pozitiv tek bizneset e vogla. Sidoqoftë, perceptcioni që investimet do rriten, sugjeron për një lirim të ritmit ekonomik të vendit, dhe rritje të investimeve të bizneseve. Ekziston një klimë mjaft stimuluese për investime, dhe një ambient mjaft i sigurt për investime.

## E ARDHMJJA E EKSPORTIT

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 8:




**Fig. 8.** E ardhmja e eksportit.

Evidenca e mësipërme sugjeron që bizneset e mëdha dhe të mesme perceptojnë që do ketë një nivel të ulët të rritjes së eksporteve, ndërsa bizneset e vogla perceptojnë që do ketë një rritje të eksportit. Megjithatë, një mesatare shumicë prej 29.6%, tek tri kategoritë e bizneseve, sugjeron që ritmi i eksportit do mbetet i njëjtë. Gjithashtu, evidenca e mësipërme sugjeron që, bizneset e mëdha dhe ato të vogla, nuk janë të afta dhe nuk kanë për qëllim që ta konsiderojnë të ardhmen e tyre drejt eksportit, por për më tepër janë të drejtuara nga furnizimi i kërkesës kombëtare.

## PROBLEMET E BIZNESIT, SIPAS RENDITJES

Përgjigjet e respondentëve janë paraqitur në figurën 9:



**Fig. 9.** Problemet e biznesit, sipas renditjes.

Siç shihet nga diagrami i mësipërm, bizneset në Kosovë prekin në pikat më themelore të sfidave të ekonomisë kosovare. Si të tilla, problemet e bizneseve në Kosovë nuk janë thjesht të natyrës materiale por edhe juridike dhe institucionale. Problemet janë të radhitura sipas nivelit të problemit që ato paraqesin në biznese në përgjithësi.

## *Përfundim/Konkluzion*

---

Të dhënat e analizuara në këtë hulumtim janë të afërta me ato të përmbledhura në hulumtimin e vitit 2010. Kemi kuptuar që bizneset e mëdha kanë perceptione të ngjajshme me bizneset e mesme dhe të vogla, me disa përjashtime ku bizneset e vogla në disa raste kanë perceptione dhe mendime më negative nga bizneset më të mëdha. Në të gjitha madhësitë e bizneseve, problemi kryesor i shprehur është ngarkesa tatimore, e përcjellë nga rryma dhe qiraja. Dallimet e përgjigjeve të bizneseve në bazë të madhësive të tyre nuk janë të rëndësishme në aspekt statistikor ( $p > 0.05$ ).